



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

**SHËRBIMI
“SHËRBIM PSIKOLOGJIK, LIGJOR DHE LINJA TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS
NË FAMILJE”**

**Shtojca 1- UDHËZUES PËR APLIKANTËT – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-
TË) NË KUADËR TË THIRRJES PUBLIKE PËR SHËRBIMIN “SHËRBIM PSIKOLOGJIK,
LIGJOR DHE LINJA TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE”**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të interesuara në procesin e dorëzimit të ofertave financiare në kuadër të Thirrjes Publike për Shërbimin “SHËRBIM PSIKOLOGJIK, LIGJOR DHE LINJA TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE”.

**ÇFARË ËSHTË THIRRJA PËR “SHËRBIM PSIKOLOGJIK, LIGJOR DHE LINJA
TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE”.**

Bashkia Durrës përmes thirrjes “Shërbim psikologjik, ligjor dhe linja telefonike, për viktimat e dhunës”, të financuar nga buxheti lokal, ka për qëllim zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Qëllimi i veçantë i Bashkisë Durrës është fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Durrës dhe shoqërisë civile lidhur me financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) edhe me buxhet të pushtetit lokal në përputhje me prioritetet lokale.

Nëpërmjet shërbimit në Bashkinë Durrës pritet nga një OSHC të ofrohet mbështetje për shërbime të specializuara për jo më pak se 60 raste në vit të viktimave të DHF/DHBGJ mbi 18 vjeç, duke synuar të ofrojë një paketë mbështetëse që përfshin shërbim psikologjik, ligjor dhe linjë telefonike.

Disa nga rezultatet që Bashkia Durrës synon të arrijë përmes kësaj thirrje janë:

- Bashkia Durrës do të përdorë modele transparente për financimin e OSHC-ve;
- OSHC-të do të ofrojnë mbështetje të cilat adresojnë nevojat e qytetarëve në Bashkinë e

- Durrës dhe janë në zbatim të planeve dhe strategjive lokale për zhvillim;
- Kapacitete të fuqizuara të OSHC-ve dhe Bashkisë Durrës për të zbatuar programet e Kujdesit Social për Familjet dhe Fëmijët dhe ofruar shërbime cilësore;
 - Përmirësimi i bashkëpunimit, dialogut, ndarjes së praktikave ndërmjet Bashkisë së Durrës dhe OSHC-ve në përputhje me frymën e legjislacionit shqiptar.

2. SYNIMI I PËRGJITHSHËM I THIRRJES PUBLIKE DHE PRIORITETET E BASHKISË DURRËS

Nëpërmjet kësaj Thirrjeje publike synohet forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësisë të pushtetit vendor. Kjo do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit me OSHC-të për të ofruar mbështetje në përkujdesje më cilësore për qytetarët. Në këtë kuadër, ftohen të gjitha OSHC-të e interesuara të dorëzojnë ofertat financiare, të cilat duhet të adresojnë shërbimet e specializuara kundër dhunës për personat mbi 18 vjeç.

Fondi do t'i ofrohet asaj organizate, që ofron ofertën më të mirë financiare për Bashkinë Durrës, që përmbushin kriteret e cilësisë dhe kushtet e tjera të kësaj thirrjeje publike, sikurse përcaktuar në këtë Udhëzues.

3. FONDET QË JANË NË DISPOZICION PËR SHËRBIMIN

Propozimet që plotësojnë kriteret e kësaj thirrjeje publike janë ato që kërkojnë një buxhet jo më shumë se **2,700,000 lekë** në vit (TVSH e Përfshirë). Marrëveshja parashikohet të zgjasë 3 vite me rinovim cdo vit.
(bazuar në nenin 103 të LPP).

Fondet e alokuara në këtë thirrje publike nuk do të mbulojnë shpenzimet administrative. E gjithë shuma e fondit do të parashikohet për shërbimet objekt i thirrjes.

Bashkia Durrës ka të drejtën për të mos ndarë fondin në dispozicion nëse ofertat financiare që dorëzohen nga OSHC-të nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

4. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për OSHC-të (qendrat, shoqatat ose fondacionet) që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë shërbimin e kërkuar, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale

- c) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ekzekutiv, që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OJF-së, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale;
- d) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për OJF-të, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; gj) ka paraqitur një Propozim të pavarur, sipas kërkesave ;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, Të gjitha dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të OJF në ditën e hapjes së propozimit, sipas Shtojcës.

Në rast bashkimi të dy apo më shumë OJF, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në çdo rast, Bashkia Durrës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga OJF për sa më sipër.

- Nëse propozimit paraqitet nga një bashkim OJF-sh, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

OSHC-të do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e fondit nëse në kohën e dorëzimit të propozimeve financiare:

- Nuk kanë patur projekte të zbatuara në qytetin e Durrësit gjatë 2 viteve të fundit.
- Nuk kanë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve të parashikuara në këtë thirrje për target grupin e synuar gjatë 5 viteve të fundit.
- Nuk kanë as vendndodhje parësore e as dytësore në Bashkinë Durrës (ky kriter është i rëndësishëm pasi Bashkia Durrës përmes buxhetit lokal synon të fuqizojë OSHC-të që operojnë në këtë bashki)

- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Më konkretisht, përjashtohen nga vlerësimi ato propozime, në të cilat: *Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për tu përfshirë në organizatën aplikuese janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil¹ si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.*
- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e ofertave financiare ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas pikës 9;
- kohëzgjatja e ofertës së propozuar është më pak se 36 muaj;

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për OSHC-të dhe OJQ-të (qendra, shoqata ose fondacione) që janë të regjistruara zyrtarisht në Shqipëri dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të aplikuar në thirrjen publike, aplikanti duhet të jetë një entitet ligjor jo-fitimprurës i regjistruar në Shqipëri në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (qendër, shoqatë ose fondacion). Aplikantët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në thirrje ose nuk do të marrin fonde nëse nuk dorëzojnë bashkë me ofertën financiare deklaratën e nënshkruar të përmbushjes së kriterëve (Shtojca 5). Aplikantët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje ose nga alokimi i fondeve nëse në kohën e dorëzimit të ofertës:

- a. kanë konflikt interesash;
- b. janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- c. janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të propozimit.

5 . KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë deri në 36 muaj.

1

Neni 31 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6. VENDI I ZBATIMIT

Shërbimet do të ofrohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Durrës.

7. LLOJET E SHËRBIMEVE

- Shërbimet që do të financohen nga buxheti lokal duhet të jenë përgatitur në përputhje me thirrjen publike.
- Shërbimet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të komunitetit lokal dhe grupeve të targetuara të identifikuara nga shërbimi.
- Shërbimet duhet të jenë paketë veprimtarish të integruara, të krijuara për të arritur qëllimet e caktuara dhe rezultatet specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore, si vijon.

Organizata e përzgjedhur do të kryejë detyrat duke u kujdesur:

- Të operojë në zbatim të dhe në përputhje me: Ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar; VKM Nr.334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”; Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR)
- Të koordinojë dhe ofrojë shërbimet përmes bashkëpunimit Korrdinatoin Vendor Kundër Dhunës, e përmes tij me Shërbimin e Provës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Urdhrin e Psikologut, me shërbimet komunitare, shërbimet në qendrat e zhvillimit, strehëzat, Qendrës për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijët dhe Familjen dhe të ngjashme me të, dhe çdo anëtar të ETN, MKR që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të administrimit vendor.
- Të bashkërendojë punën me strukturat përkatëse në komisariatet e Policisë lidhur me referimin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj grave.
- Të ndërtojë një sistem pune për parandalimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare duke marrë masat dhe duke ofruar shërbimet e nevojshme ligjore që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi si edhe dhe duke ofruar shërbimet psikologjike të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës.
- Të mbajë aktive dhe në dispozicion linjën telefonike falas 24/7 për asistimin e viktimave të DHF/DHBGJ.
- Të përcjelljë raportin mujor me të dhëna për rastet konkrete KV-së si drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor, ku të dokumentohen veprimet e ndërmarra, shërbimet e ofruara bazuar në nevoja dhe treguesit e suksesit.
- Të ruajë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktima jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktima.
- Të marrë pjesë rregullisht dhe aktivisht në mbledhjet e ETN/GTN, dhe Komitetit Drejtues të MKR

Në tërësi shërbimi në Bashkinë Durrës do të konsistojë në:

- 1. Mbështetje ligjore të rasteve të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse: Gjykatë, Polici, Përmbarrim, Prokurori etj;**
- 2. Mbështetje psikosociale për të mbijetuarat/it e dhunës në familje;**

3. Linja telefonike 24 orëshe pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje.

1. Shërbimi ligjor do të konsistojë në:

- Mbështetjen juridike (informim mbi procedurat ligjore për denoncimin në polici, kërkimin UMM/UM në gjykatë, masat ligjore ndëshkuese për dhunuesit).
- Sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit dhe shoqërimin e tyre kur është e nevojshme në gjykatë, polici dhe/ose pranëshërbimeve të tjera;
- Asistimin e viktimave në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM), si dhe për hapat që duhen ndjekur, nëse urdhri shkelet;
- Bashkëpunimin me viktimën, asistimin për mbledhjen e provave dhe orientimin në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje
- Hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, duke ofruar ndihmën juridike dytësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
- Asistimin e rastit si përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës duke ofruar ndihmë parësore dhe dytësore juridike.
- Referimin dhe orientimin e viktimës pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

2. Shërbimi psikologjik do të konsistojë në:

- Ofrimin në çdo kohë të ndihmës sociale e psikologjike për viktimën e dhunës në familje përmes bashkëpunimit me KVDHF dhe ETN;
- Ndjekjen e rastit me kërkesën e personave të interesuar ose kryesisht dhe respektimin e të drejtave të viktimave dhe fëmijëve të tyre, për plotësimin e nevojave për këshillim psikologjik ballë për ballë;
- Mbështetjen psikologjike (për të kapërcyer ndjenjat e ankthit, të pasigurisë, frikës, mungesën e shpresës për të ardhmen, luhatjet emocionale) me anë të mësimin të teknikave psikologjike;
- Këshillimin psikosocial të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe në familje përmes linjës telefonike falas
- Nxitjen e marrëdhënieve të shëndetshme me fëmijët duke kaluar kohë cilësore;
- Terapinë familjare;
- Asistencën psikologjike për gratë dhe fëmijët e mitur në Gjykatë, Polici dhe Përmbarim.
- Ndjekjen në bashkëpunim edhe me koordinatorët vendorë e me punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve të zbatimit të masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo në rastin kur fëmijët jetojnë në familje, ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin
- Ndjekjen e zbatimit të protokolleve dhe të standardeve për vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje
- Marrjen pjesë rregullisht dhe aktivisht në mbledhjet e ETN/GTN

3. Linja e telefonit 24/7 pa pagesë ofron informacion bazë ligjor, referime dhe mbështetje emocionale për viktimat e abuzimit. Ajo do të ketë qëllim:
 - Të krijojë mundësinë për viktimat, të mbijetuarit e dhunës të raportojnë atë, duke ndihmuar viktimat të kuptojnë të drejtat dhe opsionet e tyre dhe të bëjnë zgjedhjet që do të mbështesin më së miri daljen nga dhuna dhe shërimin e tyre.
 - Të ndihmojë në lidhjen e viktimave, të mbijetuarve me burimet lokale, shërbimet kundër dhunës.
 - Të ofrojë informacion mbi çdo formë të dhunës dhe edukim për identifikimin e saj
 - Të ofrojë ndihmë për planifikimin e personalizuar të sigurisë dhe ndërhyrjes në situatë krize
 - Koordinimin e ndihmës për dhunën në familje, përfshirë dhunën ndaj grave, që evidentohet në rastet e emergjencave civile dhe të gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
 - Këshillimi psikosocial i viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe në familje përmes linjës telefonike falas do të jetë një shërbim që ofrohet 24 orë, çdo ditë dhe falas nga një staf i specializuar në shërbime multidisiplinare dhe profesionist.
 - Referimin e rasteve tek institucionet shtetërore sipas nevojave të identifikuara.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e fondit:

- Aktivitetet e rregullta të organizatës aplikuese;
- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme;
- Financim projekti që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projekt për përfitime ekskluzive të individëve;
- Projekt që mbështesin partitë politike;
- Ndarjen e granteve për palë të treta;
- Blerja e pajisjeve dhe punët rehabilituese/ndërhyrjet në infrastrukturë përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brenda limiteve të shprehura në pikën 3 të Udhëzuesit.

Aktivitetet e sipërpërmendura janë shkak për refuzimin automatik të ofertës.

8. PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI

OSHC-të e interesuara duhet të aplikojnë në mënyrë individuale.

9. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

I. Dokumentet kryesore:

- Oferta financiare (formati Excel - Shtojca 2)

II. Dokumente shitesë (për organizatën aplikuese)

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ndryshime të tij nëse ka patur.

- Kopja e statutit të organizatës (për organizatën aplikuese),
- Formulari i kompletuar identifikues Financiar (formati Word– Shtojca 3),
- Deklarata e plotësimit të kriterëve e plotësuar dhe e nënshkruar (formati Word – Shtojca 8),
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin paraardhës sipas detyrimeve ligjore e firmosur nga një kontabilist/auditues i miratuar/ekspert kontabël, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Një raport përshkruar i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti, ku të mund të identifikohet veprimtaria në Bashkinë Durrës gjatë 2 viteve të fundit (shoqëruar me dokument vërtetues, psh kontrata të projekteve të zbatuara) si edhe të mund të identifikohet eksperiencia në ofrimin e shërbimeve të parashikuara (ligjor/ psikologjik/ linjë telefonike) në këtë thirrje për target grupin e synuar, të paktën për 5 vite.
- Dokumentacioni i caktimit të linjës së gjelbër telefonike pa pagesë dhe përdorimi i numeracionit i lëshuar nga AKEP.

Shënim: Me qëllim vlerësimin e propozimit financiar, dokumentacioni kryesor dhe ai shtesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje është i detyrueshëm.

10. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të **Bashkisë Durrës** do të jetë i disponueshëm nga data **25.10.2024**, pas dërgimit të një kërkesë me e-mail në adresën info@durres.gov.al ku duhet të citoni emrin e organizatës së interesuar.

Të gjitha informatat e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në ëeb-faqen zyrtare të Bashkisë (<http://www.durres.gov.al>).

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (në CD apo USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), nga ora 09:00 deri në ora 16:00, në adresën:

Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, Kodi Postar 2001, Durrës, Shqipëri

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 11.11.2024. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar emri i thirrjes publike, emri i plotë dhe adresa e aplikantit dhe fjalët: ”Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

11. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROPOZIMEVE

Vlerësimi

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e Bashkisë së Durrës ngritur me Urdhër nga Titullari AK.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) Kritereve administrative:

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 10 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 9;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).
- Konfirmimi se organizata aplikuese dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 (të përcaktuara më sipër).

(ii) Vlerësimi financiar:

Vlerësimi i ofertës financiare të propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit për seksionin “Kapacitetet financiare dhe operative”: ***Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 25, në këtë mënyrë: 1-5= shumë keq, 6-10= keq, 11-15= jo mirë; 16-20= mirë; 21-25= shumë mirë.***

Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin propozim. Radhitja e propozimeve bëhet në atë mënyrë ku propozimi i radhitur si i pari është ai i cili ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit kapacitetin financiar dhe operativ janë 100;

Vendimi për aprovimin e propozimit mbështetet mbi ofertën më të ulët. Propozimet që janë kualifikuar në fazën e vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare, kalojnë për vlerësim të ofertës financiare. Do të shpallet fituese oferta më e ulët financiare ndër propozimet e kualifikuara në kapacitetet teknike dhe financiare.

Shënim: për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm (për tu kualifikuar), oferta duhet të vlerësohet me 60 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së ofrimit të shërbimeve

si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për ofrimin e tyre me cilësi dhe në kohë.

Propozimi përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 60 pikë, ku pikët minimale për secilin nga 4 kriteret në tabelen e vlerësimit janë jo më pak se 60% ose 15 pikë.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Kapacitetet financiare dhe operative	100	
1.3 A ka aplikanti përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektsh? Vlerësim maksimal marin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim	25	
1.2 A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve të parashikuara (ligjor/ psikologjik/ linjë telefonike) në këtë thirrje për target grupin e synuar, të paktën për 5 vite.	25	
1.3. A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 15.000 Euro.	25	
A disponon aplikanti linjë telefonike pa pagesë të vënë në dispozicion nga AKEP?	25	
Pikët totale maksimale	100	

Njoftimi rreth vendimit

Në çdo rast, nëse propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për propozimin e tyre brenda 10 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike.

Vendimi për refuzimin e propozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Organizata aplikuese, nuk i përmbush kushtet dhe kriteret për kualifikim të thirrjes publike;
- Kapacitetet financiare dhe operative të organizatës aplikuese nuk janë të mjaftueshme;
- Propozimi ka qenë financiarisht jo i leverdisshëm krahasuar me propozimin e përzgjedhur për financim.

Kushtet rreth zbatimit të shërbimit pas miratimit të grantit

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës joqeveritare, propozimi i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e shërbimeve. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, organizatës mund t'i kërkohej modifikime të caktuara në propozim për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të shërbimeve.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 2 Oferta Financiare

Shtojca 3 Formulari i identifikimit financiar

Shtojca 8 Deklarata për plotësimin e kriterëve

Shtojca 2

FORMULARI I PROPOZIMIT

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF i ftuar për të paraqitur ofertën)

Data: _____

Emri i OJF dhe NIPT-i (emri i OJF ofertuese dhe NIPT-in) _____

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e procedurës me objekt: *[shënoni objektin e procedurës së publikuar]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/ Bashkia Durrës, në përputhje me Dokumentet (shih më poshtë), Shërbimet për _____ në përputhje me Propozimin Teknike, Propozimin Financiare (Buxhetin) dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumenta.
- c) Propozimi ynë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme;
 1. Njoftimin e kontratës;
 2. Kriteret e përzgjedhjes;
 3. Termat e Referencës;
 4. Listat e Çmimeve të Shërbimeve (nëse është e aplikueshme).

ç) Çmimi total i Propozimit sonë, pa TVSH, është: _____ *[OJF ofertuese vendos në shifra dhe fjalë];*

emri i përfaqësuesit të OJF-së	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3

PROPOZIMI FINANCIAR (BUXHETI)

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF-të)

Data: _____

Emri i OJF /ve (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e propozimit.

Propozimi financiar (Buxheti)

1	2	3	4	5
	Përshkrimi	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4)
	Shpenzime të Përgjithshme të administrimit			
1	Burime njerëzore			
	TOTAL 1 Burime Njerezore			
2	Shpenzime të tjera administrative			
	2.1 Shpenzime për ndriçim			
	2.2 Shpenzime për ngrohje			
	2.3 Shpenzime Uji			
	2.4 Të tjera			
	TOTAL 2 Shpenzime të tjera administrative			
	TOTAL 1+2			
3	aktivitete			
	3.1 Shërbim rezidencial për x përfitues			
	3.1.1 Shërbim Psikologjik (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.2 Punonjes sociale (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.3 Operatore sociale (nr pers x nr muajsh)			
	3.1.4 Punonjës mbështetës (sanitar + guzhinier....) nr pers x nr muajsh			
	3.1.5 Ushqim 15 persona x Y dite			

	3.2 Shërbime social kulturore			
	3.2.1 Mesuës fiskulture			
	3.2.2 Mesues muzike/ arti			
	3.2.3 Abone 15 persona x nr muajsh			
	TOTAL 3 aktivitete			
4	Furnitura			
	4.1 Set ngrënie për 15 persona (pirunj, luge, thika)			
	4.2 Detergjente të ndryshëm (për larje enesh, dysheme, banjo)			
	4.3 Set carcafe, batanie, jorgane, jastike , peshqire për 15 persona			
	4.4 Paketa higjene personale (paste dhembesh, furce dhembesh, sapu tualeti, kreher, lines,)			
	TOTAL 4 Furnitura			
5	Vizibiliteti 3%			
	5.1 Baner			
	5.2 Fletpalosje			
	5.3 Ndërtim ëeb për shërbimin			
	TOTAL 5 Vizibiliteti			
6	TOTAL 1+2+3+4+5			
7	Shpenzime të paparashikuara 1-7% e TOTALIT 6			
8	TOTAL 6+7			
Çmimi Neto pa TVSH				
TVSH (%)				
Çmimi total me TVSH:				
Emri i përfaqësuesit të OJF-së/ve				
Nënshkrimi				
Vula				
Datë _____				

Shtojca 8

FORMULARI PËRMBLEDHËS I DEKLARIMIT

(Shtojcë për t'u paraqitur nga OJF)

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të përfaqësuesit ligjor të OJF deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë si vijon:

Pjesa I: Informacion në lidhje me OJF-n

Identifikimi	Përgjigja
Emri i OJF: (Ju lutemi renditni të gjithë OJF nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e OJF në BOE	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
OJF është i regjistruar në regjistrin zyrtar sipas legjislacionit shqiptar në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e shërbimit të kërkuar, dhe ka statusin aktiv.
OJF nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata.
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OJFsë/ve, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një

periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, etj.
OJF nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
OJF nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
OJF ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi,
OJF ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për OJF-të, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
OJF ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.
OJF nuk është në listën e OJF-ve të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Propozimeve të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të OJF, në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- ▶ Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- ▶ Unë kuptoj që propozimi i paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
- ▶ Unë jam i autorizuar nga OJF të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të saj;
- ▶ Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga OJF për të përgatitur dhe për të nënshkruar propozimin në interes të OJF-së;
- ▶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe propozimit të paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo OJF tjetër ekonomik, të ndryshëm nga OJF, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - paraqesin një propozim në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, të bërë nga Autoriteti / Bashkia;
 - është një propozim i mundshëm i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojatë tij, mundet të dorëzojë një propozim në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës.
- ▶ OJF deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - OJFka përgatitur propozimin e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - OJFështë konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë. OJF deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e këtij propozimi, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

- ▶ Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një propozim; ose,
 - paraqitjen e një propozimi që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për propozim.
- ▶ Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
- ▶ Kushtet e propozimit nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga OJF konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të OJF, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e OJF-së, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala

në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive,

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e titullatit të OJF, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
<ul style="list-style-type: none">• OJF _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.• OJF_____lidh me punëmarrësitkontratat përkatëse të punës dhe garantonmasat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.• OJF_____nuk ka masë Ligjore në fuqi,të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	
Nese ka mase Ligjore ne fuqi te jepen sqarime_____	

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

Në cilësinë e OJF, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e procedurës së përzgjedhjes, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave / dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Bashkia Durrës), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me kërkesat dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Bashkia Durrës.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim OJF të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në çdo rast, Bashkia Durrës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e OJF jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, në Bashkinë Titanë.
- OJF që marrin pjesë në procedurë duhet të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Shënim:

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Bashkia Durrës duhet t'i kërkojë OJF fituese që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku Bashkia Durrës mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.